



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimit
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Rrobaqepësi

Niveli i tretë në KSHK¹, referuar nivelit III KEK²

D1-III-23

Tiranë, 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Rrobaqepësi			Kodi D1-III-23
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III KEK	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli III në KSHK , referuar nivelit III KEK, është <i>përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me rrobaqepësinë</i> . Zhvillimi te individi i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe një shkallë të gjerë njohurish profesionale janë të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në profilin mësimor “Rrobaqepësi” niveli III në KSHK , referuar nivelit III KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Tekstil-Konfeksion”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II KEK; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. - <u>kanë aftësi të ndryshe</u>, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli III në KSHK , referuar nivelit III KEK, e pajis individit me Certifikatën e përfundimit të këtij niveli si punonjës i kualifikuar në këtë fushë profesionale, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës si rrobaqepës në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të veshjeve për burra, gra dhe fëmijë, njësi të qepjes dhe riparimit të tekstileve për përdorim shtëpiak, në dyqane të ndryshme artizanale, atelie mode apo të vetëpunësohet.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV KEK (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) dhe fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit	Korrik 2023			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	D-II-01-14; D1-III-19;			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të mësuarit në:

NJOHURI

Në përfundim të kualifikimit profesional “Rrobaqepësi” **niveli III në KSHK**, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të si më poshtë:

Planifikimi dhe organizimi i vendit të punës

- Të shpjegojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ateliesë;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe organizimit të veprimtarisë ditore, javore dhe mujore;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore ;
- Të shpjegojë mjetet, pajisjet dhe makineritë, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të listojë tekstilet, llojet e fibrave dhe fillit;
- Të shpjegojë ndërtimin e pëlhurave, karakteristikat dhe mënyrën e identifikimit të tyre;
- Të përshkruajë mjetet dhe materialet ndihmëse, si dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës;
- Të përshkruajë teknikat dhe rëndësia për kontrollin e funksionalitetit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të shpjegojë llojet e makinerive, ndërtimin dhe përdorimin e tyre për realizimin e produktit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së makinerive në varësi të proceseve për realizimin e produktit;
- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Të përshkruajë rëndësinë, qëllimin dhe mënyrat e renditjes, organizimit dhe etiketimit të materialeve;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes kohës së punës;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së bazës materiale;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së furnitorëve dhe bashkëpunëtorëve;
- Të shpjegojë rregullat e plotësimit të dokumenteve të fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të mallit dhe të porosisë;
- Të shpjegojë hapat e punës përgatitjen e makinave të punës për proceset përkatëse;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të materialit tekstil;
- Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e testimit të makinerive para fillimit të punës.

Bashkëpunimi me klientin për realizimin e veshjes

- Të shpjegojë rëndësia e evidentimit të pritshmërive të klientit;
- Të shpjegojë rëndësinë e informimit të klientit me zhvillimet në fushën e tekstileve;
- Të përshkruajë tendencat e modës dhe rëndësia e informimit të klientit me përditësimin në të;

- Të shpjegojë rëndësinë e ngjyrave dhe kombinimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e përshtatjes së modelit me trupin e klientit;
- Të shpjegojë rëndësinë e dakordësimit të çmimit dhe të afateve kohore;
- Të shpjegojë rëndësinë e qëndrimit të klientit gjatë marrjes së masave dhe kryerjes së provave;
- Të shpjegojë rëndësinë e historisë së modës dhe veshjeve popullore shqiptare;

Ndërtimi i kallëpeve për modelin e zgjedhur

- Të shpjegojë mënyrën e marrjes së masave të nevojshme në trupin bazë, në përputhje me produktin;
- Të interpretojë masat e nevojshme nga tabelat e përmasave;
- Të shpjegojë mënyrën e përlllogaritjes së përmasave;
- Të listojë mjetet dhe materialet e duhura për ndërtimin e kallëpit duke përshkruar funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë zhvillimin e trupit të njeriut dhe pikat antropometrike për matjen e tij;
- Të dallojë defektet në trupin e njeriut dhe mënyrat e korrigjimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet dhe teknikat e ndërtimit të skicave bazë;
- Të argumentojë rëndësinë e verifikimit të saktësisë së skicave;
- Të interpretojë kontrollin e saktësisë së skicave të prerjes;
- Të përshkruajë llojet, funksionin e shenjave orientuese dhe rëndësinë e kontrollit të saktësisë së tyre;
- Të shpjegojë teknikat e zhvillimit të modelit të veshjeve;
- Të interpretojë një model veshjeje duke zbërthyer elementët përbërës të tij;
- Të shpjegojë llojet e pencave dhe teknikat e spostimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet e supanjat dhe teknikat e krijimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet e qemerëve dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet e dekolteve dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet jakave dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet xhepave dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet e mëngëve dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet e dorezave dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet e korseve të bustit dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të shpjegojë teknikat e krijimit të veshjeve reglan;
- Të shpjegojë teknikat e krijimit të veshjeve kimono;
- Të shpjegojë teknikat e krijimit të modeleve për artikuj të tjerë;
- Të shpjegojë rëndësinë e lirshmërisë në veshje në varësi të tekstit të përdorur
- Të shpjegojë mënyrat e prerjes së kallëpeve;
- Të përshkruajë llojet e defekteve të supeve, balancës, formës së trupit dhe gavaturës;
- Të shpjegojë teknikat e korrigjimit të defekteve të ndryshme në veshje;
- Të përshkruajë zhvillimin industrial të numrit (sistemin koordinativ).

Prerja

- Të shpjegojë llojet e metodat e testimi të pëlhurave (qëndrushmëria e ngjyrave,

- rezistenca, stabiliteti dimensional) dhe rëndësia e kontrollit të cilësisë së tyre;
- Të listojë mjetet e punës për prerje, funksionet dhe mënyra e përdorimit të tyre;
 - Të argumentojë rëndësinë e trajtimeve paraprake të tekstit;
 - Të përshkruajë rëndësinë e relaksimit të pëlhurës;
 - Të shpjegojë rëndësinë e faktorëve që ndikojnë në pozicionimin e elementëve të veshjes mbi tekstil;
 - Të përshkruajë teknikat e shtrimit të pëlhurave mbi tavolinën e prerjes;
 - Të përshkruajë teknikat e pozicionimit të kallëpeve mbi pëlhurë;
 - Të shpjegojë mënyrat e gjurmimit të elementëve të kallëpeve mbi tekstil;
 - Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të rezervave për qepje;
 - Të shpjegojë teknikat e prerjes sipas tekstit dhe modelit;
 - Të shpjegojë rëndësinë e saktësisë në prerje dhe koordinimit sy-dorë;
 - Të shpjegojë rëndësinë e renditjes dhe etiketimit të elementëve;
 - Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të saktësisë së elementëve të prerë në pëlhura dhe ndikimi i tyre në veshje;
 - Të shpjegojë teknikat e ekonomizimit të lëndës së parë në mënyrë manuale dhe elektronike;
 - Të përshkruajë mënyrat e prerjes së tekstileve;

Realizimi i provës së veshjes

- Të përshkruajë rëndësinë dhe metodat e gjurmimit të shenjave nga njëra pjesë e tekstit në tjetrën;
- Të përshkruajë teknikat e bashkimit të elementëve të veshjes;
- Të shpjegojë teknikat e përshtatjes së veshjes me trupin;
- Të listojë llojet e defekteve në veshje dhe teknikat e korigjimit të tyre;
- Të argumentojë teknikat e ndryshimit (modifikimit) të veshjes;
- Të analizojë rregullimin e veshjes pas kryerjes së provës së parë;
- Të listojë hapat e punës pas përfundimit të provës së parë dhe përgatitjen e provës së dytë;
- Të përshkruajë metodat e kontrollit të provës së dytë në trup;
- Të përshkruajë teknikat e prerjes së astarëve dhe fortesave.

Qepja

- Të përshkruajë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës për qepje;
- Të përshkruajë teknikat e realizimit të qepjeve të përkohshme me dorë;
- Të përshkruajë teknikat e bashkimit të trupit bazë të veshjes me jakën;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes së mëngëve me trupin bazë;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes së dy pjesëve të tekstit me njëra-tjetrën;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes së pencave;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes së xhëpave;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes së qemerëve;
- Të përshkruajë radhën e punës së përgatitjes së jakave;
- Të përshkruajë radhën e punës së përgatitjes së mëngëve;
- Të përshkruajë teknikat e përgatitjes së astarëve për veshje të ndryshme;

- Të përshkruajë teknikat e bashkimit të qemerëve, jakave, mëngëve, astarëve, xhepave në veshje;
- Të përshkruajë metodat e mbylljes së një veshje;
- Të shpjegojë mënyrën e ildisjes së pjesëve përbërëse sipas radhës së punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e cikatjeve në materialin e prerë;
- Të shpjegojë mënyrën e vendosjes së vatave;
- Të shpjegojë metodat e kontrollit të provës së parë në trup;
- Të listojë mënyrat e qepjeve dhe përdorimet e tyre në materiale të ndryshme veshjeje;
- Të përshkruajë përgatitjen e mostrave;
- Të përshkruajë llojet e frazelinave dhe fortesave, mjetet për ngjitjen dhe fiksimin e tyre në tekstil;

Proceset përfundimtare dhe punime dekorative të konfeksionimit të veshjes

- Të shpjegojë proceset përfundimtare të konfeksionimit të veshjeve të sipërme;
- Të shpjegojë proceset përfundimtare të konfeksionimit të veshjeve të brendshme;
- Të shpjegojë proceset e kontrollit të veshjes së përfunduar;
- Të shpjegojë teknikat e hekurosjes, sipas specifikimeve teknike materialeve tekstile;
- Të specifikojë dokumentacionin/etiketat që shoqëron një veshje dhe domethënia e shenjave të tyre;
- Të shpjegojë teknikat e kthimit të palës;
- Të listojë mënyrat dhe llojet e distancave mes birave;
- Të shpjegojë teknikat e realizimit, praktik dhe estetik, të birave;
- Të shpjegojë teknikat e realizimit, praktik dhe estetik të kopsave;
- Të shpjegojë metodat e qepjes së elementëve të tjerë bashkues;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së punimeve të dorës dhe teknikat e realizimit të tyre në varësi të produktit;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit të penjve;
- Të përshkruajë llojet e etiketave dhe teknikat e vendosjes së tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit përfundimtar të veshjes;
- Të listojë mjetet ndihmëse hekurosëse, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë teknikat e hekurosjes dhe përdorimet e tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e palosjes dhe paketimit të veshjes;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të programeve kompjuterike për projektimin dhe dizenjimin e konfeksioneve dhe aksesorëve;
- Të listojë lloje të ndryshme të tegelave dekorues;
- Të përshkruajë teknikat e realizimit të tegelave dekorues;
- Të përshkruajë modelet e thjeshta të qëndisjes dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të listojë llojet e ndryshme të aplikacioneve dhe mënyrat e vendosjes së tyre në veshje;
- Të listojë aksesorët, mjetet dhe materialet për dekorim, si dhe mënyrat e vendosjes së tyre në veshje;
- Të përshkruajë dorashkat, llojet dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të përshkruajë kapelet, llojet dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të përshkruajë çantat prej tekstili, llojet dhe teknikat e realizimit të tyre;

- Të përshkruajë rripat, llojet dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të përshkruajë kordelet, lulet, bizhuteritë me tekstil, llojet dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të argumentojë rëndësinë e leximit të etiketave të veshjes;
- Të listojë mënyrat e modifikimit të veshjes;
- Të përshkruajë mënyrat e riparimit dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë arnimin, llojet dhe teknikat e realizimit të tyre.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknikë dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e leximit dhe interpretimit të manualeve të pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknikë dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinerive të ndryshme;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknikë dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
- Të listojë mjetet, mënyrat dhe procedura e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të shpjegojë rëndësinë e interpretimit dhe respektimit të sinjalistikave në mjedisin e punës;
- Të përshkruajë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
- Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit dhe mënyrën e përdorimit të pajisjeve të MZSH³;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës gjatë punës;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes dhe magazinimit të materialeve të rrezikshme sipas standardeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit në mënyrë racionale të energjisë dhe materialeve;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e mbledhjes, klasifikimit dhe paketimit të mbetjeve, kryesisht atyre të rrezikshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të distancave në vendin e punës për evitimin e aksidenteve në punë;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të duhura në raste pandemie dhe endemie.

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të përshkruajë llojet e dokumentacioneve të punës;
- Të përshkruajë parimet kryesore të Kodit të Punës, legjislacionin bazë të fushës së tekstil-konfeksionit lidhur me aktivitetin që kryen;

³ Mbrojtja dhe Shpëtimi ndaj Zjarrit

- Të shpjegojë llojet e faturave dhe mënyrat e plotësimit të faturave të thjeshta (fletë analizë, fletë hyrje, fletë dalje etj.);
- Të tregojë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
- Të shpjegojë si funksionon tregu për çmimet dhe cilësinë e materialeve, bazuar në standardet e caktuara;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së kostos së materialeve dhe çmimit të një shërbimi;
- Të përshkruajë mënyrat e regjistrimit të të dhënave dhe përgatitjes së ofertave për produktet apo shërbimet;
- Të tregojë teknikat e marketingut;
- Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
- Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit me literaturat profesionale;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përshkruajë rregullat për një komunikim të suksesshëm në vendin e punës (iniciativës, korrektësisë, vetëkontrollit);
- Të shpjegojë metodat e komunikimit dhe parimet e kodit të etikës;
- Të përshkruajë rëndësinë e të dëgjuarit dhe të kuptuarit në një komunikim;
- Të argumentojë rëndësinë e punës në ekip/grup dhe zbatimin e parimeve kryesore;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e koordinimit të veprimtarive me kolegët dhe vartësit;
- Të dallojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
- Të tregojë llojet e aktorëve dhe rolin e tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të argumentojë rolin e TIK⁴-ut në komunikimin me të tretët;
- Të tregojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të tregojë rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e shprehjes saktë dhe në mënyrë profesionale;

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Rrobaqepësi” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë shprehitë profesionale, si më poshtë:

Planifikimi dhe organizimi i vendit të punës

- Të kryejë organizimin dhe vendosjen në funksionim të ateliesë;
- Të kryejë organizimin e veprimtarive ditore, javore dhe mujore;
- Të kryejë planifikimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore ;
- Të përdorë mjetet, pajisjet dhe makineritë, sipas funksionit përkatës;
- Të dallojë në mënyrë organoleptike tekstilet, llojet e fibrave dhe fillit;
- Të dallojë ndërtimin e pëlhurave dhe karakteristikat e tyre;
- Të përdorë mjetet dhe materialet ndihmëse;

⁴ Teknologji e informacionit dhe Komunikimit

- Të kryejë kontrollin e pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës;
- Të zbatojë teknikat për kontrollin e funksionalitetit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të përdorë llojet e makinerive për realizimin e produktit;
- Të përzgjedhë makineritë në varësi të proceseve për realizimin e produktit;
- Të kryejë organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Të kryejë renditjen, organizimin dhe etiketimin e materialeve;
- Të llogarisë kohën e punës dhe bazën materiale të nevojshme për realizimin e produktit;
- Të përzgjedhë furnitorët dhe bashkëpunëtorët;
- Të plotësojë dokumente të fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve, të mallit dhe të porosisë;
- Të kryejë përgatitjen e makinave të punës për proceset përkatëse;
- Të kryejë kontrollin e materialit tekstil sipas metodës përkatëse;
- Të kryejë testimin e makinerive para fillimit të punës.

Bashkëpunimi me klientin për realizimin e veshjes

- Të evidentojë pritshmëritë e klientit;
- Të informojë klientin me zhvillimet në fushën e tekstileve;
- Të këshillojë klientin lidhur me tendencat e modës;
- Të kombinojë ngjyrat sipas kërkesës së klientit;
- Të realizojë përshtatjen e modelit me trupin e klientit;
- Të dakordësojë me klientin për çmimin dhe afatet kohore;
- Të udhëzojë klientin për mënyrën e qëndrimit gjatë marrjes së masave dhe kryerjes së provave;
- Të informojë klientin lidhur me historinë e modës dhe veshjeve popullore shqiptare;

Ndërtimi i kallëpeve për modelin e zgjedhur

- Të kryejë marrjen e masave të nevojshme në trupin bazë në përputhje me produktin që do realizojë;
- Të interpretojë masat e nevojshme nga tabelat e përmasave;
- Të përlllogaritë përmasat për realizimin e produktit;
- Të përdorë mjetet dhe materialet e duhura për ndërtimin e kallëpit sipas funksionit;
- Të evidentojë pikat antropometrike të trupit të njeriut;
- Të identifikojë dhe korrigjojë defektet në trupin e njeriut;
- Të ndërtojë skicat bazë në varësi të teknikës së përzgjedhur;
- Të verifikojë saktësinë e skicave;
- Të evidentojë llojet, funksionin e shenjave orientuese dhe rëndësinë e kontrollit të saktësisë së tyre;
- Të zhvillojë modelin e veshjeve me anë të teknikave të ndryshme;
- Të zbërthejë në element modelin e veshjes;
- Të përzgjedhë llojet e pencave dhe teknikat e spostimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e supanjave dhe teknikat e krijimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e qemerëve dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e dekolteve dhe teknikat e realizimit të tyre;

- Të përzgjedhë llojet jakave dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet xhepave dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e mëngëve dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e dorezave dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e korseve të bustit dhe teknikat e realizimit të tyre;
- Të zbatojë teknikat e krijimit të veshjeve reglan;
- Të zbatojë teknikat e krijimit të veshjeve kimono;
- Të realizojë modele për artikuj të tjerë me anë të teknikave të ndryshme;
- Të përcaktojë lirshmërinë në veshje në varësi të tekstilit të përdorur;
- Të kryejë prerjen e kallëpeve;
- Të evidentojë llojet e defekteve të supeve, balancës, formës së trupit dhe gavaturës;
- Të korrigjojë defekte të ndryshme në veshje;
- Të realizojë zhvillimin industrial të numrit (sistemin koordinativ).

Prerja

- Të kryejë testimin e pëlhurave (qëndrueshmëria e ngjyrave, rezistenca, stabiliteti dimensional) dhe kontrollin e cilësisë së tyre me anë të metodave të ndryshme;
- Të përzgjedhë mjetet e punës për prerjen, sipas funksionit dhe mënyrës së përdorimit të tyre;
- Të kryejë trajtime paraprake të tekstilit;
- Të realizojë relaksimimin e pëlhurës;
- Të pozicionojë elementët e veshjes mbi tekstil në varësi të modelit të veshjes dhe llojit të tekstilit;
- Të realizojë shtrimin e pëlhurave mbi tavolinën e prerjes;
- Të pozicionojë kallëpet mbi pëlhurë;
- Të kryejë gjurmimin e elementëve të kallëpeve mbi tekstil;
- Të përcaktojë rezervat për qepje;
- Të kryejë prerjen në varësi të tekstilit dhe modelit;
- Të realizojë saktë prerjen dhe koordinimin sy-dorë;
- Të kryejë renditjen dhe etiketimin e elementëve;
- Të kontrollojë saktësinë e elementëve të prerë në pëlhura dhe ndikimin e tyre në veshje;
- Të ekonomizojë lëndën e parë në mënyrë manuale dhe elektronike;
- Të përzgjedhë mënyrat e prerjes së tekstileve;

Realizimi i provës së veshjes

- Të zbatojë metodat e gjurmimit të shenjave nga njëra pjesë e tekstilit në tjetrën;
- Të zbatojë teknikat e bashkimit të elementëve të veshjes;
- Të realizojë përshtatjen e veshjes me trupin;
- Të kryejë identifikimin dhe korrigjimin e defekteve në veshje;
- Të zbatojë teknikat e ndryshimit (modifikimit) të veshjes;
- Të realizojë rregullarin e veshjes pas kryerjes së provës së parë;
- Të zbatojë hapat e punës pas përfundimit të provës së parë dhe të përgatis provën e dytë;
- Të realizojë kontrollin e provës së dytë në trup;

- Të zbatojë teknikat e prerjes së astarëve dhe fortesave.

Qepje

- Të përcaktojë radhën e punës për qepje;
- Të zbatojë teknikat e realizimit e qepjeve të përkohshme me dorë;
- Të realizojë ildisje të pjesëve përbërëse sipas radhës së punës;
- Të realizojë cikatje në materialin e prerë;
- Të zbatojë teknikat e bashkimit të trupit bazë të veshjes me jakën;
- Të zbatojë teknikat e qepjes së mëngëve me trupin bazë;
- Të përzgjedhë llojet e frazelineve dhe fortesave, mjetet për ngjitjen dhe fiksimin e tyre në tekstil;
- Të zbatojë teknikat e qepjes së dy pjesëve të tekstilit me njëra-tjetrën;
- Të zbatojë teknikat e qepjes së pencave;
- Të zbatojë teknikat e qepjes së xhepave;
- Të zbatojë teknikat e qepjes së qemerëve;
- Të zbatojë radhën e punës së përgatitjes së jakave;
- Të zbatojë radhën e punës së përgatitjes së mëngëve;
- Të zbatojë teknikat e përgatitjes së astarëve për veshje të ndryshme;
- Të zbatojë teknikat e bashkimit të qemerëve, jakave, mëngëve, astarëve, xhepave në veshje;
- Të përzgjedhë metodat e mbylljes së një veshje;
- Të realizojë vendosjen e vatave;
- Të zbatojë metodat e kontrollit të provës së parë në trup;
- Të realizojë mënyra të ndryshme qepjeje sipas llojit të materialit;
- Të realizojë përgatitjen e mostrave;

Proceset përfundimtare dhe punime dekorative të konfeksionimit të veshjes

- Të kryejë proceset përfundimtare të konfeksionimit të veshjeve të sipërme;
- Të kryejë proceset përfundimtare të konfeksionimit të veshjeve të brendshme;
- Të kryejë proceset e kontrollit të veshjes së përfunduar;
- Të zbatojë teknikat e hekurosjes, sipas specifikimeve teknike materialeve tekstile;
- Të plotësojë dokumentacionin/etiketat që shoqëron një veshje;
- Të zbatojë teknikat e kthimit të palës;
- Të zbatojë teknikat e realizimit, praktik dhe estetik, të birave;
- Të zbatojë teknikat e realizimit, praktik dhe estetik të kopsave;
- Të përdorë metodat e qepjes së elementëve të tjerë bashkues;
- Të përzgjedhë punimet e dorës dhe teknikat e realizimit të tyre në varësi të produktit;
- Të realizojë mënyrat e pastrimit të penjve;
- Të përdorë mjetet ndihmëse hekurosëse, sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Të zbatojë teknikat e hekurosjes;
- Të zbatojë mënyrat e palosjes dhe paketimit të veshjes;
- Të kryejë kontrollin përfundimtar të veshjes;
- Të përzgjedhë llojet e etiketave dhe teknikat e vendosjes së tyre;

- Të zbatojë teknikat e realizimit të tegelave dekorues;
- Të realizojë modelet e thjeshta të qëndisjes sipas teknikave përkatëse;
- Të realizojë llojet e ndryshme të aplikacioneve dhe mënyra të vendosjes së tyre;
- Të përdorë aksesorët, mjetet dhe materialet për dekorim;
- Të zbatojë teknikat e realizimit të dorashkave sipas llojit;
- Të zbatojë teknikat e realizimit të kapeleve sipas llojit;
- Të zbatojë teknikat e realizimit të çantave prej tekstili sipas llojit;
- Të zbatojë teknikat e realizimit të rripave sipas llojit;
- Të zbatojë teknikat e realizimit të kordeleve, luleve, bizhuterive me tekstil sipas llojit;
- Të realizojë teknikat e modifikimit të veshjes;
- Të zbatojë mënyrat e riparimit në veshje dhe artikuj të tjerë;
- Të zbatojë teknikat e arnimit;
- Të zbatojë mënyrat e paketimit dhe ambalazhimit të produktit të përfunduar;

Sigurimi teknik

- Të zbatojë manualët e pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të zbatojë parime të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit;
- Të kryejë mbledhjen, klasifikimin dhe paketimin e mbetjeve dhe kryesisht atyre të rrezikshme;
- Të zbatojë mënyrat e ndryshme të riciklimit të mbetjeve teknologjike;
- Të respektojë distancat në vendin e punës për evitimin e aksidenteve në punë;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknikë dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknikë dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
- Të zbatojë mënyrat dhe procedura e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të respektojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
- Të zbatojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të përdorë pajisje të MZSH në raste zjarri;
- Të zbatojë rregullat e higjienës gjatë punës;
- Të respektojë rregullat e ruajtjes dhe magazinimit të materialeve të rrezikshme sipas standardeve;
- Të përdorë në mënyrë racionale energjinë dhe materialet;
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie dhe epidemie.

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të përzgjedhë llojet e dokumentacioneve të punës;
- Të zbatojë parimet kryesore të Kodit të Punës, legjislacionin bazë të fushës, lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të plotësojë fatura të thjeshta (fletë analizë, fletë hyrje, fletë dalje etj.);

- Të respektojë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
- Të studiojë tregun për çmimet dhe cilësinë e materialeve, bazuar në standardet e caktuara;
- Të llogaritë koston e materialeve dhe çmimin e një shërbimi;
- Të regjistrojë të dhënat dhe të përgatitë oferta për produktet dhe shërbimet;
- Të zbatojë teknikat e marketingut;
- Të zbatojë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
- Të përditësohet me literaturat profesionale;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të zbatojë rregullat për një komunikim të suksesshëm në vendin e punës (iniciativës, korrektësisë, vetëkontrollit);
- Të zbatojë metodat e komunikimit dhe parimet e kodit të etikës;
- Të punojë në ekip/grup duke zbatuar parimet përkatëse;
- Të bashkëpunojë me kolegët dhe vartësit.
- Të zbatojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
- Të përzgjedhë aktorët sipas rolit të tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të përdorë TIK në komunikimin me të tretët;
- Të përdorë terminologjinë profesionale;
- Të respektojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

